



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.130

5 shtator

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.789, datë 22.7.2009	Për notifikimet në zbatim të marrëveshjeve, për barrierat teknike në tregti dhe të masave sanitare e fitosanitare, të Organizatës Botërore të Tregtisë.....	6073
Vendim i KM nr.791, datë 22.7.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Qaf-Shuli 1, 2 e 3” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	6077
Vendim i KM nr.804, datë 22.7.2009	Për përcaktimin e çmimit të trojeve, në zonat industriale, ku ushtrohen veprimtari ekonomiko-industriale, në objektet e ndërtuara mbi këto troje.....	6077
Vendim i KM nr.824, datë 29.7.2009	Për përballimin e shpenzimeve të fushatave sensibilizuese për promovimin e dhurimit vullnetar, pa pagesë, të gjakut, nga organizatat jofitimprurëse	6078
Vendim i KM nr.825, datë 29.7.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe miratimin e kuotave dhe të tarifës për këtë program	6079
Vendim i KM nr.826, datë 29.7.2009	Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë” në Universitetin Bujqësor të Tiranës	6079
Vendim i KM nr.827, datë 29.7.2009	Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë” në Universitetin e Tiranës	6080
Vendim i KM nr.828, datë 29.7.2009	Për hapjen e programit të studimeve “Master i nivelit të dytë” në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të Universitetit Politeknik të Tiranës	6081

Vendim i KM nr.829, datë 29.7.2009	Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë” në Fakultetin e Muzikës të Akademisë së Arteve dhe miratimin e kuotave dhe të tarifave për këto programe	6082
Vendim i KM nr.830, datë 29.7.2009	Për licencimin e shkollës “Shkolla e lartë private e edukimit”	6083
Vendim i KM nr.831, datë 29.7.2009	Për një shtesë në vendimin nr.320, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale”, të ndryshuar.....	6084
Vendim i KM nr.832, datë 29.7.2009	Për mbylljen e disa programeve të studimit të universitetit ushtarak “Skënderbej”, Tiranë, dhe transferimin e studentëve të këtij universiteti në universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Politeknik të Tiranës.....	6085
Vendim i KM nr.833, datë 8.7.2009	Për përcaktimin e rregullave për kontratat e përdorimit me afat të pasurive të paluajtshme.....	6086
Vendim i KM nr.835, datë 15.7.2009	Për një shtesë në vendimin nr.42, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar.....	6088
Vendim i KM nr.836, datë 15.7.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Zëmbllak-Liqenas, Korçë	6089
Vendim i KM nr.837, datë 29.7.2009	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.248, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”	6094
Vendim i KM nr.838, datë 22.7.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës qendër Mallakastër të qarkut të Fierit.....	6094
Vendim i KM nr.839, datë 22.7.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shijak të qarkut të Durrësit.....	6096
Urdhër i MD nr.6325, datë 31.7.2009	Për miratimin e rregullores “Për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit”	6097

VENDIM
Nr.789, datë 22.7.2009

**PËR NOTIFIKIMET NË ZBATIM TË MARRËVESHJEVE, PËR BARRIERAT TEKNIKE
NË TREGTI DHE TË MASAVE SANITARE E FITOSANITARE, TË ORGANIZATËS
BOTËRORE TË TREGTISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 5, shkronja “f”, 14 e 22, të ligjit nr.9870, datë 4.2.2008 “Për standardizimin”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e përdorura nënkuptohen:

1. Barriera teknike në tregti, sipas OBT-së:

a) Rregulli teknik është dokumenti, i cili përcakton karakteristikat e produktit ose proceset e lidhura me të dhe metodat e prodhimit, përfshirë dispozitat administrative, të detyrueshme për t’u zbatuar. Mund të përmbajë ose të merret ekskluzivisht me terminologjinë, simbolet, ambalazhimin, marketimin ose kërkesat për etiketimin, që kanë të bëjnë me produktin, procesin apo metodën e prodhimit.

Rregullat teknike përfshijnë:

i) “Rregullat administrative” të një shteti anëtar, të cilat u referohen specifikimeve teknike dhe kërkesave të tjera ose rregullave për shërbimet, kodet profesionale, si dhe kodet e praktikës së mirë, të cilat, nga ana e tyre, u referohen specifikimeve teknike ose kërkesave të tjera, që përputhen me detyrimet e vendosura në rregullat administrative, të sipërpërmendura;

ii) “Marrëveshjet vullnetare”, të cilat një autoritet publik është palë kontraktuese, që parashikojnë, në interes të publikut, përputhjen me veçoritë teknike, ose kërkesa të tjera, përjashtuar veçoritë e prokurimit të tenderit publik;

iii) “Specifikime teknike”, të dhënat në një dokument, të cilat japin karakteristikat e kërkuara për një produkt, të tilla si niveli i cilësisë, vetitë, siguria, përmasat, përfshirë edhe terminologjinë, simbolet, provat, metodat e analizave, paketimin dhe etiketimin e produktit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

iv) “Projekt standard”, dokumenti, që përmban tekstin e specifikimeve teknike për një subjekt të caktuar, i cili miratohet në përputhje me procedurën e standardeve kombëtare, pasi ka qarkulluar për shqyrtim dhe koment;

v) “Projektrregull teknik”, teksti i një specifikimi teknik a i një kërkesë tjetër ose rregulli për shërbimet, ku përfshihen masat administrative, që synojnë ta vënë atë në zbatim si një rregull teknik, kur teksti është në fazën e përgatitjes, që do të thotë se mund t’i bëhen përmirësime të mëtejshme thelbësore;

vi) “Program standardesh”, një program pune i një organi të njohur zyrtarisht si organizëm standardizimi, i cili rendit temat, për të cilat kryhet standardizimi;

vii) “Produkt”, çdo produkt, industrial dhe bujqësor, përfshirë edhe produktet e peshkut;

viii) “Shërbim”, çdo shërbim, që jepet kundrejt një pagese, në distancë, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe sipas kërkesës individuale të atij, që e kërkon këtë shërbim;

ix) “Rregulla për shërbimet”, kërkesat e përgjithshme, që lidhen me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së shërbimit sipas përkufizimit të mësipërm, në veçanti, me dispozitat për ata që e ofrojnë këtë shërbim, të atyre që e kryejnë dhe të atyre që përfitojnë nga ky shërbim, përjashtuar çdo rregull, që nuk synon, në mënyrë të veçantë, shërbimet;

x) “Kërkesa të tjera”, kërkesat, përveç specifikimeve teknike, të cilat janë vendosur për një produkt, për mbrojtjen e konsumatorit ose të mjedisit, që ndikojnë në ciklin e qarkullimit, pasi produkti të jetë hedhur në treg. Të tilla janë kushtet e përdorimit, riciklimi, ripërdorimi ose prirja, kur mund të ndikojnë, në mënyrë domethënëse, në përbërjen ose natyrën e produktit a vendosjen e tij në treg.

b) Standard dokumenti, miratuar nga një organ i njohur, që për përdorim, të përsëritur ose të përgjithshëm, përcakton rregulla, udhëzime apo karakteristika për produkte a procese, që lidhen me to dhe metodat e prodhimit, zbatimi i të cilave nuk është i detyrueshëm. Ai mund të përmbajë ose mund të trajtojë, në mënyrë ekskluzive, terminologjinë, simbolet, ambalazhimin, marketimin ose kërkesat për etiketimin, që kanë të bëjnë me produktin, procesin a metodën e prodhimit.

c) Procedurat e vlerësimit të konformitetit, çdo procedurë e përdorur, që duhet të kryhet plotësisht, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për të përcaktuar kërkesat përkatëse për rregullat teknike ose standardet.

ç) Organi ose sistemi ndërkombëtar, çdo organ ose sistem, ku anëtarësimi është i hapur për organet e ngjashme, të paktën të të gjitha vendeve anëtare.

d) Organi ose sistemi rajonal, çdo organ ose sistem ku anëtarësimi është i hapur për organet e ngjashme vetëm për disa nga vendet anëtare.

dh) Organi i qeverisjes qendrore, qeveria qendrore, ministritë dhe departamentet e saj ose çdo organ, që është subjekt i kontrollit të qeverisjes qendrore për veprimtarinë në fjalë.

e) Njësitë e qeverisjes vendore, qeverisja vendore, e ndryshme nga qeveria qendrore (d.m.th. e shteteve, provincave, landëve, kantoneve, bashkive, etj.) ministritë ose departamentet e saj, a çdo organ, që është subjekt i kontrollit të kësaj qeverisjeje, për veprimtarinë në fjalë.

ë) Organi joqeveritar, organi i ndryshëm nga organi i qeverisë qendrore ose ai i qeverisjes vendore, i cili ka autoritetin ligjor të zbatojë një rregull teknik.

2. Masat sanitare dhe fitosaniatre, sipas OBT-së

a) Masat sanitare dhe fitosaniatre janë masat e zbatuara për të mbrojtur shëndetin dhe jetën e kafshëve apo për të ruajtur bimët nga rreziqet, që rezultojnë nga hyrja, vendosja, apo përhapja e parazitëve, sëmundjeve, organizmave, bartës sëmundjesh ose organizmave patogjenë, kimikate shtesë, infektuesit, toksinat ose organizmat patogjenë, që janë të pranishme në produktet bujqësore, pijet apo ushqimet për kafshë, sëmundjet e bartura nga kafshët, bimët a produktet e tyre.

b) Me masat sanitare apo fitosanitare nënkuptojmë të gjitha:

i) ligjet, dekretet, rregulloret, kërkesat dhe procedurat që lidhen me to, përfshirë këtu, ndër të tjera, kriteret, që lidhen me produktin përfundimtar;

ii) procedurat dhe metodat e prodhimit;

iii) procedurat e testimit, të inspektimit, të certifikimit dhe të homologimit;

iv) regjimet e karantinës, përfshirë edhe kërkesat për transportin e kafshëve a të bimëve dhe të lëndëve, të nevojshme për mbijetesën e tyre gjatë transportit;

v) dispozitat, në lidhje me metodat statistikore, procedurat e nxjerrjes së mostrave dhe mënyrat e vlerësimit të rreziqeve, që lidhen me to;

vi) kërkesat për ambalazhimin dhe etiketimin, që lidhen drejtpërdrejt me parrezikshmërinë e produkteve ushqimore.

II. Notifikimet sipas marrëveshjes OBT/TBT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) është autoriteti kombëtar i notifikimit dhe pika kombëtare e referimit në OBT, për dhënien e informacionit për standardet, rregullat teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit me ndikim në tregti.

DPS-ja njofton sekretariatit e OBT-së, në Gjenevë, edhe përsa i përket anëtarësimit, me të drejta të plota apo në një nivel më të ulët, të organeve përkatëse të shtetit shqiptar në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, të standardizimit e të atyre të vlerësimit të konformitetit, si dhe për marrëveshjet dy ose shumëpalëshe për standardet, rregullat teknike ose procedurat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë brenda kuadrit të marrëveshjes së OBT-së.

2. Organet e qeverisjes qendrore, vendore dhe ato joqeveritare, të cilat kanë pushtet juridik për të detyruar zbatimin e rregullave teknike, sapo të nisin përgatitjen e një standardi, të një rregulli teknik ose një procedure për vlerësimin e konformitetit, duhet të njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, e cila bën njoftimin përkatës në sekretariatit e OBT-së.

3. Kërkesa nga organet e qeverisjes qendrore, vendore dhe joqeveritare, për njoftim në sekretariatit e OBT-së, dërguar me shkresë zyrtare në DPS, përmban:

- kopje të projektstandardit, rregullit teknik ose procedurës së vlerësimit të konformitetit;
- arsyen e përgatitjes së këtij projekti;
- dokumentet, mbi të cilat mund të jetë mbështetur projekti;
- afatet e adoptimit dhe të zbatimit të masave të propozuara në projekt.

4. Në rastin e një kërkesë të tillë, DPS-ja njofton sekretariatit të OBT-së për masat që po përgatiten, si dhe organin, që ka bërë kërkesën për njoftim, se nuk duhet të adoptojë masat në fjalë 60 ditë pas ditës, që sekretariati i Organizatës Botërore të Tregtisë, në Gjenevë, ka bërë njoftimin.

5. Notifikimi në sekretariatit të OBT-së do të përmbajë:

- bazën ligjore për përgatitjen e një standardi, rregulli teknik apo procedure vlerësimi të konformitetit;
- të dhëna për standardet, europiane dhe ndërkombëtare, rregullat teknike, udhëzuesit dhe referencat, të cilat përbëjnë bazat për masat që propozohen;
- të dhëna për produktet dhe shërbimet e mbuluara, sipas masave që po përgatiten;
- qëllimet dhe arsyet për përgatitjen e këtyre masave;
- arsyet për çdo devijim nga dokumentet e mësipërme, nëse është rasti.

6. DPS-ja, pasi merr komentet (kur ka të tilla) nga shtetet anëtare të OBT-së, nëpërmjet sekretariatit të OBT-së, ia dërgon ato organit, që ka bërë kërkesë për njoftim, duke i kërkuar këtij organi të paraqesë tek ajo, brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike, një projekt me komentet e pasqyruara, i cili duhet të përcaktojë, në mënyrë të qartë, nëse këto komente janë marrë parasysh dhe, nëse po, mënyrën se si këto janë reflektuar, plotësisht apo pjesërisht, si dhe arsyet për secilin rast.

Përgjigjja e plotë komunikohet tek anëtarët e OBT-së, të cilët kanë bërë komente për masat, që po përgatiten, nëpërmjet DPS-së.

7. Të gjitha masat e këtij vendimi, që lidhen me procedurën e njoftimit, do të zbatohen edhe për çdo ndryshim ose përmirësim thelbësor të standardeve, rregullave teknike apo procedurave të vlerësimit të konformitetit, me ndikim në tregti, për afatin e adoptimit dhe të zbatimit të tyre, si dhe për radhën e produkteve, për të cilat do të zbatohet.

8. DPS-ja, në funksion të pikës kombëtare të referimit për standardet, rregullat teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit, ua përcjell organeve përkatëse, sipas fushës, pyetjet dhe kërkesat e arsyeshme të vendeve të tjera anëtare dhe të palëve të interesuara. Organet përkatëse do të kthejnë përgjigje, me shkrim, brenda 15 ditëve kalendarike, në DPS, e cila ia dërgon atë brenda 3 ditëve kalendarike shtetit tjetër anëtar apo palës së interesuar.

9. Ministrinë e linjës dhe institucionet, kur vlerësojnë se adoptimi i masës së propozuar nga çdo shtet anëtar i OBT-së dhe i publikuar nga sekretariati i OBT-së në faqen e saj të internetit, mund të ketë ndikim në tregtinë ndërkombëtare, dërgojnë në DPS kërkesën zyrtare, me pyetjet, komentet apo sugjerimet e tyre. Në bazë të kërkesës së bërë, DPS-ja ia dërgon atë menjëherë shtetit anëtar të OBT-së, i cili ka propozuar masën në fjalë. DPS-ja duhet ta nisë kërkesën e ardhur brenda një periudhe prej 3 deri 5 ditësh nga marrja e saj.

III. Notifikimet, sipas marrëveshjes OBT/SPS

1. Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) është autoriteti kombëtar i notifikimit dhe pika e referimit në OBT për masat sanitare dhe fitosanitare me ndikim në tregti dhe ka përgjegjësinë e zbatimit të aneksit B të marrëveshjes së OBT-së për transparencën e masave sanitare dhe fitosanitare, veçanërisht të paragrafëve 3, 4, 5, 6, 7 e 8 të tij.

2. Organet shtetërore, sapo të nisin përgatitjen e një mase sanitare dhe fitosanitare, duhet të njoftojnë menjëherë Drejtorinë e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Informacioni duhet të përmbajë:

- bazën ligjore për masat e propozuara;
- të dhënat për produktet dhe shërbimet e mbuluara, sipas masave që po përgatiten;
- qëllimet dhe arsyet për përgatitjen e këtyre masave;
- afatet e adoptimit dhe të zbatimit të masave të propozuara.

Bashkëlidhur me informacionin duhet të jetë një projekt i masave, që propozohen.

4. Notifikimi në sekretariatit të OBT-së përmban:

- bazën ligjore për masat e propozuara;
- të dhëna për standardet, europiane dhe ndërkombëtare, rregullat teknike, udhëzuesit dhe referencat, të cilat përbëjnë bazat për masat, që propozohen;
- të dhënat për produktet dhe shërbimet e mbuluara, sipas masave që po përgatiten;
- qëllimet dhe arsyet për përgatitjen e këtyre masave dhe natyrën e problemit apo të problemeve urgjente;
- kohën e hyrjes në fuqi të masave të propozuara.

5. MBUMK-ja, me kërkesën e shteteve anëtare të interesuara, jep kopje të masave të propozuara dhe u përgjigjet të gjitha pyetjeve të arsyeshme, të ardhura nga vendet anëtare, për masat e propozuara.

6. MBUMK-ja, pasi merr komentet (kur ka të tilla) nga shtetet anëtare të OBT-së, nëpërmjet sekretariatit të OBT-së, ia dërgon ato organit/drejtorisë, që ka propozuar apo vendosur masa sanitare e fitosanitare.

7. MBUMK-ja i kërkon organit/drejtorisë, që ka kërkuar njoftimin, të paraqesë, brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike, një projekt, me komentet e pasqyruara, i cili duhet të përmbajë, në mënyrë të qartë, nëse këto komente janë marrë parasysh dhe, nëse po, mënyrën se si nëse janë reflektuar, plotësisht apo pjesërisht, si dhe arsyet për secilin rast.

Përgjigjja e plotë u komunikohet anëtarëve të OBT-së, të cilët kanë bërë komente për masat që po përgatiten, nëpërmjet MBUMK-së.

8. MBUMK-ja, në funksion të pikës kombëtare të referimit në OBT për masat sanitare dhe fitosanitare me ndikim në tregti, përcjell tek organet përkatëse, sipas fushës, pyetjet dhe kërkesat e arsyeshme (në rastin kur këto janë jashtë kompetencës së vet) të vendeve të tjera anëtare dhe palëve të interesuara. Organet përkatëse e japin përgjigjen e tyre, me shkrim, brenda 15 ditëve kalendarike, në MBUMK, e cila ia dërgon atë brenda 5 ditëve kalendarike shtetit tjetër anëtar apo palës së interesuar.

9. Ministrinë e linjës dhe institucionet, kur vlerësojnë se adoptimi i masës së propozuar nga çdo shtet, anëtar i OBT-së, dhe i publikuar nga sekretariati i OBT-së, në faqen e internetit, mund të ketë ndikim në tregtinë ndërkombëtare, dërgojnë në MBUMK kërkesën zyrtare, me pyetjet, komentet apo sugjerimet, që mund të kenë. Në bazë të kësaj kërkeje, MBUMK-ja ia dërgon atë menjëherë shtetit anëtar të OBT-së, i cili ka propozuar masën në fjalë. MBUMK-ja do ta nisë kërkesën e ardhur brenda një periudhe prej 3 deri 5 ditësh nga marrja e saj.

10. Detyrimet, që rrjedhin nga zbatimi i direktivës 98/34/EC “Për shkëmbimin e informacionit për standardet, rregullat teknike dhe rregullat për shërbimet e informacionit të shoqërisë”, do të plotësohen kur Shqipëria të jetë vend anëtar i Bashkimit Europian.

IV. Vendimi nr.382, datë 22.7.2002 i Këshillit të Ministrave “Për shkëmbimin e të dhënave në fushën e standardeve dhe të rregullave teknike”, shfuqizohet.

V. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.791, datë 22.7.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “QAF-SHULI 1, 2 E 3” DHE MIRATIMIN E
BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurës ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim, transferim), të hidrocentraleve “Qaf-Shuli 1, 2 e 3”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 pikëve për rezultatin, teknik e financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Hoxha-L” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Qaf-Shuli 1, 2 e 3”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.804, datë 22.7.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË TROJEVE, NË ZONAT INDUSTRIALE, KU
USHTROHEN VEPRIMTARI EKONOMIKO-INDUSTRIALE, NË OBJEKTET E
NDËRTUARA MBI KËTO TROJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çmimi i trojeve, pronë shtetërore, në zonat industriale, ku ushtrohet veprimtari ekonomiko-industriale, në objektet e ndërtuara mbi to, është sa vlera e çmimit të trojeve të kategorive, të miratuara me vendimet nr.1620, datë 26.11.2008 “Për miratimin e trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna”, nr.555, datë 29.8.2007 “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Beratit, Gjirokastrës, Vlorës e të Dibrës, si dhe qytetet Bulqizë, Burrel, Klos dhe Vlorë”, nr.653, datë 29.9.2007 “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Lezhës, Dibrës, Korçës dhe Kukësit” dhe nr.139, datë 13.2.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, të Këshillit të Ministrave. Me këtë çmim do të llogaritet jo vetëm sipërfaqja nën objekt, por edhe ajo në funksion

të tij. Në rast privatizimi të këtyre trojeve, pagesa do të bëhet 50 për qind në lekë dhe 50 për qind me lekë privatizimi, letra me vlerë apo bono privatizimi.

2. Zona industriale janë të gjitha ato zona, të miratuara si të tilla me vendim të KRRT-së, dhe të KRRTRSH-së në bazë të akteve ligjore në fuqi, për kryerjen e veprimtarive ekonomiko-prodhuese.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për nxjerrjen e udhëzimit përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.824, datë 29.7.2009

**PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË FUSHATAVE SENSIBILIZUESE PËR
PROMOVIMIN E DHURIMIT VULLNETAR, PA PAGESË, TË GJAKUT, NGA
ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 78 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009” dhe të neneve 12, shkronja “c”, e nenit 13/1, të ligjit nr.9739, datë 21.5.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizatave jofitimprurëse, që kryejnë fushata sensibilizuese për promovimin e dhurimit vullnetar, pa pagesë, të gjakut, t’u financohen shpenzimet e promocionit, për dhurim, në masën 1 700 (një mijë e shtatëqind) lekë, sipas marrëveshjeve përkatëse me Ministrinë e Shëndetësisë.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti, që Ministria e Shëndetësisë i jep Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.825, datë 29.7.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E
MJEKËSISË VETERINARE TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS, SI DHE
MIRATIMIN E KUOTAVE DHE TË TARIFËS PËR KËTË PROGRAM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare të Universitetit Bujqësor të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, në mjekësi veterinare.
 2. Në përfundim të këtij programi studimesh të doktoratës, lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr), në mjekësi veterinare.
 3. Kohëzgjatja e këtij programi studimesh të doktoratës, është, të paktën, 3 (tri) vite, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
 4. Kuota e pranimi në këtë program studimi, për vitin 2009, është 30.
 5. Tarifa e shkollimit është 400 000 (katërqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga fakulteti përkatës. Doktorantët, nga stafi akademik i brendshëm i institucioneve të arsimit të lartë, paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.
 6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Bujqësor të Tiranës.
 7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.826, datë 29.7.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË
UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimeve, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, sipas fakulteteve, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, si më poshtë vijon:
 - A. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit:
 - a) Në “Teknologji mjedisi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në teknologji mjedisi.
 - b) Në “Menaxhimi i resurseve dhe përmirësimi gjenetik i bimëve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në menaxhimin e resurseve dhe përmirësimin gjenetik të bimëve.

c) Në “Kontrolli i integruar i parazitëve në bimë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në kontroll i integruar i parazitëve në bimë.

ç) Në “Hortikulturë e qëndrueshme”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në hortikulturë e qëndrueshme.

d) Në “Shkencat e prodhimit shtazor”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në shkencat e prodhimit shtazor.

B. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit:

a) Në “Ekonomi dhe agrobiznes”, me profilet:

i) “Menaxhimi i ndërmarrjeve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në ekonomi dhe agrobiznes, me profil menaxhimi i ndërmarrjeve.

ii) “Ekonomi dhe politika agrare”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në ekonomi dhe agrobiznes, me profil ekonomi dhe politika agrare.

iii) “Zhvillimi rural i integruar”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në ekonomi dhe agrobiznes, me profil zhvillim i integruar rural.

iv) “Menaxhim financiar”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në ekonomi dhe agrobiznes, me profil menaxhim financiar.

C. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare:

a) Në “Mjekësi veterinare”, me profilet:

i) “Diagnozë laboratorike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në mjekësi veterinare, me profil diagnozë laboratorike.

ii) “Klinikë veterinare”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në mjekësi veterinare, me profil klinikë veterinare.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të dytë” realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është, minimumi, një vit.

3. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Bujqësor të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.827, datë 29.7.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimeve, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në fakultetet e Universitetit të Tiranës, si më poshtë vijon:

A. Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë:

a) Në “Gjuhësi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në gjuhësi.

b) Në “Studime letrare”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në studime letrare.

c) Në “Shkencë e bibliotekave”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në shkencë e bibliotekave.

ç) Në “Gjeografi”, me drejtimet:

i) “Gjeografi fizike dhe mjedisore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në gjeografi, me drejtim gjeografi fizike dhe mjedisore.

ii) “Gjeografi humane dhe rregullim territori”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), gjeografi humane dhe rregullim territori.

B. Fakultetin e Shkencave Sociale:

a) Në “Kërkime në edukim”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në kërkime në edukim.

b) Në “Kërkim psikologjik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në kërkim psikologjik.

c) Në “Kërkim shkencor në punë sociale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në kërkim shkencor në punë sociale.

C. Fakultetin e Drejtësisë:

a) Në “Shkenca juridike civile”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në shkenca juridike civile.

b) Në “Shkencat penale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në shkencat penale.

c) Në “E drejta kushtetuese, e krahasuar dhe evropiane”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në e drejta kushtetuese, e krahasuar dhe evropiane.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të dytë” realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është, minimumi, një vit.

3. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin e Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.828, datë 29.7.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË ELEKTRIKE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË
TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në “Automatikë dhe teknologjitë e kontrollit”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në automatikë dhe teknologjitë e kontrollit.

2. Programi i studimeve “Master i nivelit të dytë” realizohet me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është, minimumi, një vit.

3. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.829, datë 29.7.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË
FAKULTETIN E MUZIKËS TË AKADEMISË SË ARTEVE DHE MIRATIMIN E
KUOTAVE DHE TË TARIFAVE PËR KËTO PROGRAME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Muzikës të Akademisë së Arteve, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në:

a) “Kompozim”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në kompozim.

b) “Muzikologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në muzikologji.

c) “Interpretim”, me profilet:

i) “Piano”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil piano.

ii) “Violinë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil violinë.

iii) “Violë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil violë.

iv) “Violonçel”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil violonçel.

v) “Klarinetë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil klarinetë.

vi) “Flaut”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil flaut.

vii) “Muzikë dhome”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil muzikë dhome.

2. Këto programe studimi realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është, minimumi një vit.

3. Kuota e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, është 15, prej së cilës 2 për kandidatët nga jashtë kufijve të vendit.

4. Tarifa e shkollimit për këto programe studimi është 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi.

5. Studentët e shkëlqyer nga cikli paraardhës i studimeve nuk e paguajnë tarifën e shkollimit.

6. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Akademinë e Arteve.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Akademia e Arteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.830, datë 29.7.2009

PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS “SHKOLLA E LARTË PRIVATE E EDUKIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës “Shkolla e lartë private e edukimit”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. “Shkolla e lartë private e edukimit” do të organizohet në dy fakultete:

a) Fakultetin e Shkencave të Edukimit, që do të ofrojë programin e studimit, të ciklit të dytë, në “Shkencat e edukimit”, në formën e studimeve me kohë të plotë, dhe programin e studimit “Master i nivelit të parë”, në “Shkencat e edukimit”.

b) Fakultetin e Menaxhimit dhe të Administrimit, që do të ofrojë programin e studimit “Master i nivelit të parë”, në “Menaxhim dhe administrim i arsimit”.

3. “Shkolla e lartë private e edukimit” do të ofrojë programin e studimit të ciklit të dytë, me kohëzgjatje 2 vite akademike, me plotësimin, së paku, të 120 krediteve. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND), në “Shkencat e edukimit”.

4. “Shkolla e lartë private e edukimit” do të ofrojë programet e studimit “Master i nivelit të parë”, të cilat janë pjesë e studimeve të ciklit të dytë, me, së paku, plotësimin e 60 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP), në:

a) Shkencat e edukimit;

b) Menaxhim dhe administrim i arsimit.

5. Ngarkohet “Shkolla e lartë private e edukimit”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

6. “Shkolla e lartë private e edukimit” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

7. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. “Shkolla e lartë private e edukimit” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.831, datë 29.7.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 320, DATË 19.3.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SISTEMIN E IDENTIFIKIMIT TË KAFSHËVE DHE TË REGJISTRIMIT TË FERMAVE BLEGTORALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pikat 6, 7, 38 e 39, 24, shkronja “b”, e 32, pika 6, të ligjit nr.9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar” dhe të nenit 4 të ligjit nr.8702, datë 1.12.2000 “Për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 6 të vendimit nr.320, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Një pjesë e këtij fondi, sipas kërkesës së Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të kalojë çdo vit në llogarinë e thesarit të kësaj ministrie, për mbulimin e nevojave vjetore në procesin e matrikullimit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM
Nr.832, datë 29.7.2009

**PËR MBYLLJEN E DISA PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË UNIVERSITETIT
USHTARAK “SKËNDERBEJ”, TIRANË, DHE TRANSFERIMIN E STUDENTËVE TË
KËTIJ UNIVERSITETI NË UNIVERSITETIN E TIRANËS DHE NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 24 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 35, pika 1, e 42, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e programeve të studimit, të ciklit të parë, me kohë të plotë, “Administrim biznesi” dhe “Inxhinieri elektronike”, në universitetin ushtarak “Skënderbej”, Tiranë.

2. Transferimin e studentëve, që studiojnë në Fakultetin e Menaxhimit, dega administrim biznesi, në universitetin ushtarak “Skënderbej”, Tiranë, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

3. Transferimin e studentëve, që studiojnë në Fakultetin Teknik, dega inxhinieri elektronike, në universitetin ushtarak “Skënderbej”, Tiranë, në Fakultetin Elektrik të Universitetit Politeknik të Tiranës.

4. Rektorati i Universitetit të Tiranës, Rektorati i Universitetit Politeknik të Tiranës dhe dekanët e fakulteteve të universitetit ushtarak “Skënderbej”, Tiranë, të marrin të gjitha masat për transferimin e studentëve, të përmendur në pikat 2 e 3 të këtij vendimi.

5. Ministria e Mbrojtjes të vazhdojë respektimin e kontratës me studentët e përcaktuar në pikat 2 e 3 të këtij vendimi, në interes të përgatitjes së tyre për oficerë të Forcave të Armatosura, dhe të mbulojë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit pranë Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Politeknik të Tiranës.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Rektorati i Universitetit të Tiranës, Rektorati i Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe rektorati i universitetit ushtarak “Skënderbej”, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.833, datë 8.7.2009

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KONTRATAT E PËRDORIMIT ME AFAT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 42 e 61 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për kontratat e përdorimit me afat të pasurive të paluajtshme, në mbështetje të neneve 42 e 43 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

2. Për qëllime të këtij vendimi, pasuri e paluajtshme është çdo ndërtesë ose pjesë ndërtese, që është trupëzuar, në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme, me tokën ose ndërtesën, e drejta e përdorimit e së cilës për akomodim është objekt i lidhjes së kontratës.

3. Tregtari, përpara lidhjes së kontratës për përdorimin me afat të pasurive të paluajtshme, i siguron konsumatorit, me shkrim, krahas të dhënave të përcaktuara në pikat 1 e 3 të nenit 43 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, edhe të dhënat e mëposhtme:

a) Një përshkrim të përgjithshëm të pasurisë, që ofrohet për përdorim për një periudhë të caktuar;

b) Të dhëna për pronarin e pasurisë së paluajtshme dhe/ose përfaqësuesin e tij, nëse ka, përfshirë emrin, mbiemrin, atësinë, numrin e identitetin personal dhe vendbanimin, titullin, numrin e regjistrimit të biznesit, si dhe adresën e regjistruar, statusin ligjor e strukturën organizative të tregtarit, në kohën e lidhjes së kontratës;

c) Vendin, ku ndodhet pasuria, periudhën e vitit, gjatë së cilës mund të përdoret pasuria e paluajtshme, të dhëna për rregullat ligjore, që drejtojnë ushtrimin e së drejtës së përdorimit me afat të pasurisë së paluajtshme, brenda territorit të vendit të huaj, në të cilin pasuria/pasuritë në fjalë ndodhet/ndodhen, dhe nëse këto rregulla janë përmbushur ose nëse jo, çfarë kushtesh mbeten për t’u përmbushur;

ç) Kur pasuria është e përcaktuar, një përshkrim të saktë të saj, si dhe vendndodhjen;

d) Kur pasuria e paluajtshme është në ndërtim:

i) nëse ka, të dhëna për ekzistencën e lejes së ndërtimit, numrin e lejes së ndërtimit, emrin dhe adresën e plotë të autoritetit supervisor. Nëse punimet e ndërtimit nuk kërkojnë dorëzimin e lejes së ndërtimit, datën e fillimit të punimeve të ndërtimit;

ii) gjendjen përfundimtare të shërbimeve, që e bëjnë pasurinë e paluajtshme plotësisht funksionale (gazi, energjia elektrike, ngrohja qendrore, uji dhe lidhjet telefonike);

iii) garancinë për përfundimin e pasurisë së paluajtshme ose një garanci për rimbursimin e çdo pagese të bërë nga konsumatori, në rast se pasuria nuk ka përfunduar në kohë, si dhe kushtet që drejtojnë veprimin e këtyre garancive.

dh) Shërbimet (ndriçimi, uji, mirëmbajtja, heqja e mbeturinave), për të cilat konsumatori ka ose do të ketë mundësinë e përdorimit, si dhe kushtet përkatëse;

e) Komoditetet e shërbimet e përbashkëta të pasurisë, për të cilat edhe konsumatori do të ketë mundësinë e përdorimit, të tilla si: pishina, sauna etj., si dhe kushtet e përdorimit të tyre;

ë) Mënyrat, në bazë të të cilave do të bëhen mirëmbajtja, riparimi dhe administrimi i pasurisë së paluajtshme;

f) Një vlerësim të shumës, që duhet të paguhet nga konsumatori për përdorimin e komoditeteve dhe të shërbimeve të përbashkëta të pasurisë, mënyrën e llogaritjes së shumës së detyrimeve të lidhura me zotërimin e pasurisë, detyrimet e parashikuara ligjërisht (si taksat dhe tarifat), si dhe shpenzimet administrative për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e pasurisë;

g) Të dhëna për të drejtën e anulimit ose të heqjes dorë nga kontrata dhe të dhëna për personin, tek i cili mund të dërgohet letra e anulimit ose heqjes dorë; përcaktimi i mënyrave, sipas

të cilave mund të dërgohet letra; dhënia e saktë e natyrës dhe shumës së kostove, të cilat do t'i kërkojnë konsumatorit t'i mbulojë, në zbatim të pikës 13 të këtij vendimi, nëse ai ushtron të drejtën e heqjes dorë;

gj) Të dhëna për masat për anulimin e marrëveshjes së kredisë, lidhur me kontratën për blerjen e së drejtës së përdorimit me afat të pasurisë së paluajtshme, në rast se konsumatori anulon ose heq dorë nga kjo e fundit;

h) Udhëzime për informacion të mëtejshëm.

4. Të dhënat e përcaktuara në pikat 1 e 3 të nenit 43 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe në pikën 3 të këtij vendimi, do të përfshihen tërësisht në kontratën për blerjen e së drejtës së përdorimit me afat të pasurisë së paluajtshme dhe do të hartohen në formën e një dokumenti, në gjuhën shqipe.

5. Të dhënat e përcaktuara në pikat 3 e 4 të këtij vendimi, mund të ndryshohen vetëm:

a) me marrëveshje të përbashkëta ndërmjet tregtarit dhe konsumatorit;

b) sipas ndryshimeve, që rrjedhin prej rrethanave jashtë kontrollit të tregtarit.

Çdo ndryshim në këto të dhëna do t'i komunikohet, me shkrim konsumatorit, përpara lidhjes së kontratës.

6. Kontrata për blerjen e së drejtës së përdorimit me afat të pasurisë së paluajtshme duhet që shprehë qartë ndryshimet e bëra në të dhënat, referuar pikave 3 e 4 të këtij vendimi.

7. Çdo publicitet për pasurinë e paluajtshme, objekt të kontratës, për blerjen e së drejtës së përdorimit me afat të pasurisë së paluajtshme, do të tregojë mundësinë e sigurimit të të dhënave, të përcaktuara në pikat 3 e 4 të këtij vendimi, si dhe adresën, ku mund të gjendet.

8. Kontrata për blerjen e së drejtës së përdorimit me afat të pasurisë së paluajtshme, një kopje e së cilës i jepet konsumatorit, duhet të jetë me shkrim, në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë, të paktën:

a) të dhënat e përcaktuara në pikat 1 e 3 të nenit 43 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”;

b) të dhënat për veçoritë e përcaktuara në të gjitha shkronjat e pikës 3 të këtij vendimi, përfshirë të dhënat për konsumatorin, i cili është njëra nga palët e kontratës.

9. Nëse konsumatori është rezident në Republikën e Shqipërisë, kontrata për blerjen e së drejtës së përdorimit me afat të pasurisë së paluajtshme dhe të dhënat e përcaktuara në pikat 1 e 3 të nenit 43 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe në pikat 3 deri 7 të këtij vendimi, hartohen në gjuhën shqipe.

10. Konsumatori ka të drejtën e anulimit të kontratës brenda tre muajve nga data e nënshkrimit të saj nga të dyja palët ose nga data e nënshkrimit të kontratës paraprake, me kusht që, në çastin e nënshkrimit, kontrata nuk ka të dhënat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “ç” e “d” të pikës 3 të nenit 43 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve” ose të dhënat e përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “f”, “g” e “gj” të pikës 3 të këtij vendimi, ose ato të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 8 të këtij vendimi, apo të dhënat për natyrën e saktë të së drejtës, e cila është objekt i kontratës, e për çmimin, që duhet të paguajë konsumatori.

11. Kur tregtari, brenda një periudhe tremujore, siguron të dhënat e përcaktuara në pikën 10 të këtij vendimi, konsumatori ka të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, brenda një periudhe prej 14 ditësh kalendarike, duke filluar nga data kur është siguruar kjo e dhënë, pa asnjë shpenzim dhe/ose penalizim.

12. Nëse, me përfundimin e periudhës tremujore, të përcaktuar në pikën 11 të këtij vendimi, konsumatori nuk ka ushtruar të drejtën e anulimit të kontratës dhe kontrata nuk përmban të dhënat e përcaktuara në pikën 10 të këtij vendimi, konsumatorit i jepet e drejta e heqjes dorë nga kontrata brenda katërmëbëdhjetë ditëve kalendarike, duke filluar nga data, që pason përfundimin e periudhës së përcaktuar në pikën 11 të këtij vendimi, pa shpenzime dhe/ose penalizim.

13. Konsumatori, i cili ka për qëllim të ushtrojë të drejtën e vet sipas pikës 5 të nenit 43 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, njofton, me shkrim, personin e treguar në kontratë, në zbatim të shkronjës “g” të pikës 3 të këtij vendimi. Njoftimi është i vlefshëm kur është paraqitur me shkrim dhe i është dërguar tregtarit përpara përfundimit të afatit të periudhës së përcaktuar në nenin 43 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

14. Kur konsumatori ushtron të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, në përputhje me pikën 5 të nenit 43 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, ai paguan vetëm shpenzimet e kryera nga tregtari, si rezultat i heqjes dorë nga kontrata, e që korespondojnë me formalitetet ligjore, të cilat duhet të përfundohen përpara mbarimit të periudhës së 14 ditëve kalendarike, të përcaktuara në pikën 5 të nenit 43 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”. Këto shpenzime duhet të jenë të shprehura qartë në kontratë.

15. Nëse konsumatori ushtron të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, sipas përcaktimit të bërë në pikën 11 të këtij vendimi, ai nuk i paguan tregtarit asnjë kompensim a penalizim.

16. Çdo marrëveshje dhe/ose çdo kusht kontraktual, ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit, që është në kundërshtim me dispozitat e neneve 42 e 43 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe të këtij vendimi, dhe në dëm të interesave të konsumatorit, ose që redukton përgjegjësinë e tregtarit, të parashikuar në këtë vendim, vlerësohet e pavlefshme dhe shfuqizohet.

17. Nëse pasuria e paluajtshme ndodhet në një shtet të huaj, ndërkohë që konsumatori është rezident në Republikën e Shqipërisë, ai nuk privohet nga mbrojtja, që i jep ligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe ky vendim, pavarësisht nga ligjet e zbatueshme për kontratën, nëse kontrata lidhet në vendin e rezidencës së konsumatorit.

18. Në rast shkeljeje të kërkesës të pikave 8 e 9 të këtij vendimi, kontrata për blerjen me afat të së drejtës së përdorimit të pasurisë së paluajtshme, vlerësohet e pavlefshme dhe shfuqizohet.

19. Për çështjet, që nuk janë të rregulluar me nenet 42 e 43 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe me këtë vendim, zbatohen dispozitat e pjesës V “Kontratat” të Kodit Civil.

20. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.835, datë 15.7.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.42, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE
PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT,
KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË
VEPRIMTARI NDËRTIMI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të shkronjës “b” të pikës 1 të kreut III “Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet” të rregullores, që i bashkëlidhet vendimit nr.42, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohej të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit të prokurimit publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet

6088

standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.836, datë 15.7.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR ZËMBLAK-LIQENAS, KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Zëmbllak-Liqenas, Korçë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 55 (pesëdhjetë e pesë) m² tokë/truall, me vlerë 95 315 (nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë) lekë, dhe sipërfaqen 3 327 (tre mijë e treqind e njëzet e shtatë) m² tokë/arë, me vlerë 1 583 733 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit është 1 679 048 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyzet e tetë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 662 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 1 679 048 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyzet e tetë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë më 1.8.2009 dhe të përfundojë më 30.10.2009.
 7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë, që do t’i vihet në dispozicion nga pronarët.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
 DREJTORIA JURIDIKE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “ZËMBLAK-LIQENAS”

Rrethi: Korçë
 Komuna: Pojan
 Fshati Zemblak

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. pasur.	Sip. totale	Lloji i pasurisë						Vlera Totale	Shënime
							Arë	Çmimi	Vlera	Truall	Çmimi	Vlera		
							M ²	(Lekë)	(lekë)	M ²	(lekë)	(lekë)	(lekë)	
1	Nevzat	Emin	Cenolli	3903	279/1	600				55	1733	95315	95315	Konf.ZRPP
2	Dhimitri	Xhemali	Kolaqis	3903	123/16	1646.5	24	804	19296				19296	Konf.ZRPP
3	Kristaq	Xhemali	Kolaqis	3903	123/17	1646.5	34	804	27336				27336	Konf.ZRPP
4	Myzafer	Islam	Bujari	3903	124/44	1202	90	804	72360				72360	Konf.ZRPP
5	Nijat	Tosun	Bujari	3903	124/43	1602	23	804	18492				18492	Konf.ZRPP
6	Florenc	Shefqet	Hoxhalli	3903	123/9	921	17	804	13668				13668	Konf.ZRPP
7	Shefqet	Zyfer	Hoxhalli	3903	123/10	1549	3	804	2412				2412	Konf.ZRPP
8	Albert	Guradem	Kulla	3903	117/110	440	121	804	97284				97284	Konf.ZRPP
9	Albert	Guradem	Kulla	3903	117/124	240	17	804	13668				13668	Konf.ZRPP
10	Driton	Ibraim	Kulla	3903	120/22	336	318	804	255672				255672	Konf.ZRPP
11	Driton	Ibraim	Kulla	3903	120/17	1300	180	804	144720				144720	Konf.ZRPP
12	Nuri		Muca	3903	120/15	1183	78	804	62712				62712	Konf.ZRPP
13	Meleq	Hysen	Telaj	3903	120/14	1423	248	804	199392				199392	Konf.ZRPP
14	Ylber	Feti	Mullalli	3903	121/14	1400	107	804	86028				86028	Konf.ZRPP
15	Hekuran	Zydi	Kulla	3903	120/1	731	82	804	65928				65928	Konf.ZRPP
16	Gurazie	Esat	Kalaja	3903	105/9	3679	112	804	90048				90048	Konf.ZRPP
17	Astrit	Beqir	Ivani	3903	6/15	2552	33	804	26532				26532	Konf.ZRPP
18	Sendiar	Beqir	Ivani	3903	6/16	2552	29	804	23316				23316	Konf.ZRPP
	Shuma (lekë)						1516		1218864			95315	1314179	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
 DREJTORIA JURIDIKE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “ZËMBLAK-LIQENAS”

Rrethi: Korçë
 Komuna: Pojan
 Fshati: Buçimas

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. pasur.	Sip. totale	Lloji i pasurisë						Vlera Totale	Shënime
							Arë M ²	Çmimi (lekë)	Vlera (lekë)	Truall M ²	Çmimi (lekë)	Vlera (lekë)		
1	Ramadan	Ilmi	Kodra	1321	11/1	864	95	465	44175				44175	Konf. ZRPP
2	Viktor dhe Adnand		Qylafi	1321	12/1	1268	42	465	19530				19530	Konf. ZRPP
3	Xhemal	Tahir	Mankolli	1321	12/2	1756	8	465	3720				3720	Konf. ZRPP
	Shuma lekë						145		67425				67425	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
 DREJTORIA JURIDIKE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “ZËMBLAK-LIQENAS”

Rrethi: Korçë

Komuna: Pojan

Fshati: Zvezde

					Nr.	Sip.	Lloji i pasurisë						Vlera	
Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	pasur.	totale	Arë M ²	Çmimi (lekë)	Vlera (lekë)	Truall M ²	Çmimi (lekë)	Vlera (lekë)	Totale (lekë)	Shënime
1	Server	Haxhi	Xhuti	3952	481/1	500	72	309	22248				22248	Konf. ZRPP
2	Dhimitër	Haxhi	Leka	3952	481/3	489	60	309	18540				18540	Konf. ZRPP
3	Dhimitër	Haxhi	Leka	3952	481/5	480	47	309	14523				14523	Konf. ZRPP
4	Dhimitër	Haxhi	Leka	3952	481/7	500	66	309	20394				20394	Konf. ZRPP
5	Dhimitri	Haxhi	Leka	3952	481/9	280	36	309	11124				11124	Konf. ZRPP
6	Dhimitri	Haxhi	Leka	3952	481/11	630	35	309	10815				10815	Konf. ZRPP
	Shuma (lekë)						316		97644				97644	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
 DREJTORIA JURIDIKE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “ZËMBLAK-LIQENAS”

Rrethi: Korçë
 Komuna: Liqenas
 Fshati: Lajthizë

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr.	Sip.	Lloji i pasurisë						Vlera	Shënime
					pasur.	totale	Arë M ²	Çmimi (lekë)	Vlera (lekë)	Truall M ²	Çmimi (lekë)	Vlera (lekë)	totale (lekë)	
1	Kuzman	Thanas	Mazenkovski	2639	713/1	580	354	148	52392				52392	Konf.ZRPP
2	Kuzman	Thanas	Mazenkovski	2639	713/2	1260	778	148	115144				115144	Konf.ZRPP
3	Stiljan	Jorgji	Sotiri	2639	703/1	600	35	148	5180				5180	Konf.ZRPP
4	Stefan	Mitre	Risto	2639	717/7	1200	120	148	17760				17760	Konf.ZRPP
5	Stefan	Mitre	Risto	2639	719/9	1160	18	148	2664				2664	Konf.ZRPP
6	Andon	Leko	Stojani	2639	712	2960	18	148	2664				2664	Konf.ZRPP
7	Petko	Kristin	Kazllari	2639	747/8	740	27	148	3996				3996	
	Shuma (lekë)						1350		199800				199800	

VENDIM
Nr.837, datë 29.7.2009

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 248, DATË 27.4.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.248, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Përcakton standardet TIK, që do të përdorin Kryeministria, ministritë dhe institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit/ministrit. Këto standarde publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Në rastet kur standardet mungojnë dhe/ose janë të pazbatueshme, institucionet e mësipërme janë të detyruara, në çdo rast, të marrin, përpara fillimit të procedurave të prokurimit publik, mendimin e AKSHI-t.” .

b) Pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l”, me këtë përmbajtje:

“l) Gjatë planifikimit të projektbuxhetit të shtetit, Ministria e Financave duhet të marrë mendimin e AKSHI-t, i cili është organ teknik-këshillimor i institucioneve, të përmendura në shkronjën “ç”, për kërkesat e tyre, për financimin me fonde buxhetore të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.” .

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik, që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.838, datë 22.7.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS QENDËR MALLAKASTËR TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Mallakastër të qarkut të Fierit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe

administrativ të komunës Qendër Mallakastër të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.1607, datë 10.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Mallakastër të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Mallakastër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna: Qendër Mallakastër

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore (pronat me nr.rendor 13,14 ndodhen brenda godinës së shkollës)	Në pronësi
15-23	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik (pronat me nr.rendor 18,20,22, ndodhen brenda godinës së shkollës)	Në pronësi
24-27	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
28-45	Varreza publike	Në pronësi
46-50	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
64	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
68-85	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
86-92	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive)	Në pronësi
226-227	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
228-249	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

VENDIM
Nr.839, datë 22.7.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË SHIJAK TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Shijak të qarkut të Durrësit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 24 (njëzet e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 105 (njëqind e pesë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Shijak

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
8,9,104,105	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
15-17	Varrezat publike	Në pronësi
40-43, 45 (vetëm trojet)	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
18-39, 44 40-43, 45 (vetëm sheshet) 46-49	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
50-53	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
54-65	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
97,98	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
96,99	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive).	Në pronësi

URDHËR
Nr.6325, datë 31.7.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR BASHKËPUNIMIN E SHËRBIMIT TË
PROVËS ME OJF-TË DHE SHËRBIMIN E NDËRMJETËSIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 31/7 të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Enkelejd Alibeaj

RREGULLORE
**PËR BASHKËPUNIMIN E SHËRBIMIT TË PROVËS ME OJF-TË DHE SHËRBIMIN E
NDËRMJETËSIMIT**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave në lidhje me bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit për të siguruar:

- a) Mbikëqyrjen e të dënuarit në përputhje me programin individual të trajtimit;
- b) Asistencën dhe mbështetjen e të dënuarit për kapërcimin e vështirësive në lidhje me riintegrimin social dhe për përmbushjen e nevojave shoqërore të edukimit, arsimimit, punësimit, strehimit dhe nevojave të tjera të ngjashme;
- c) Hartimin dhe realizimin e programeve efçente të sjelljes për të dënuarin, bazuar në nevojat e identifikuar të tij, realizimin e programeve dhe veprimtarive në qendra ditore, si dhe të ndërhyrjeve të tjera me ndikim potencial në rehabilitimin e të dënuarit;
- ç) Vlerësimin e të dënuarve, kur për hartimin e raportit nevojiten analiza të specializuara mbi shëndetin e tyre mendor, abuzimin me substanca alkoolike, narkotike apo psikotrope ose analiza të tjera të cilat mund të kryhen nga OJF-ja;
- d) Sistemimin e të dënuarve të liruar me kusht duke përgatitur dhe ofruar programe të lirimit, mundësi strehimi, arsimit, trajnimit dhe punësimit, veprimtari në qendra ditore, programe terapeutike apo të kujdesit dhe çdo ndërhyrje tjetër të nevojshme për rehabilitimin e ish- të dënuarve;
- dh) Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të dëmtuarve nga vepra penale dhe të dënuarve; si dhe
- e) Reduktimin dhe parandalimin e kriminalitetit.

2. Çdo zyrë vendore e Shërbimit të Provës ka detyrimin të identifikojë në nivel lokal OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit të interesuar për bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe të mbajë dhe përditësojë një listë të këtyre institucioneve partnere të mundshme me qëllim kontaktimin e tyre brenda një kohe sa më të shkurtër kurdo që nevojitet bashkëpunimi. Kjo listë e përditësuar i paraqitet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës në fund të çdo muaji.

3. Dispozitat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, edhe ndaj OJF-ve dhe Shërbimit të Ndërmjetësimit.

Neni 2 Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

a) “I dënuari” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”. Ky term përfshin gjithashtu personin nën hetim dhe të pandehurin.

b) “Letër Referencë” është dokumenti që Shërbimi i Provës i paraqet OJF-së apo Shërbimit të Ndërmjetësimit dhe që përmban një përshkrim të shkurtër të të dënuarit, si më poshtë:

- të dhënat e kontaktit;
- natyrën dhe kohëzgjatjen e dënimit përfshirë dhe detyrimet e vendosura nga gjykata, kur është rasti i tillë;
- të dhëna mbi sfondin social, arsimor dhe profesional;
- gjendjen e tij shëndetësore, mendore dhe fizike duke përfshirë, kur është rasti, edhe varësinë ndaj ndonjë substance;
- të dhënat e kontaktit të të dëmtuarit nga vepra penale , vetëm kur këto janë të mundshme dhe nevojiten për programin e ndërmjetësimit;
- rekomandimin e Shërbimit të Provës në lidhje me llojin e ndërhyrjeve apo veprimtarive që nevojitet të kryhen nga OJF-ja apo Shërbimi i Ndërmjetësimit;

c) “OJF” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga ligji nr. 8788, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar.

ç) “Memorandum bashkëpunimi” është marrëveshja e nënshkruar midis Drejtorisë së Shërbimit të Provës dhe OJF-së ose Shërbimit të Ndërmjetësimit me objekt veprimtaritë e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 1 të kësaj rregulloreje.

d) “Programet e ndërmjetësimit” janë të gjithë programet për ndërmjetësimin midis të dëmtuarit dhe të dënuarit, konsultimet familjare, në grup ose çdo lloj tjetër ndërhyrjeje në kuadër të drejtësisë restauruese me qëllim normalizimin e marrëdhënieve midis tyre;

dh) “Programet e sjelljes kriminale” janë programet e trajtimit/rehabilitimit që përdorin metoda të sjelljes njohëse dhe lloje të tjera të ndërhyrjeve të cilat mund të realizohen përgjatë një periudhe të caktuar kohore ndaj të dënuarit, individualisht ose në grup, me qëllim:

- i. reduktimin e sjelljeve agresive duke iu mësuar si të kontrollojnë dhe menaxhojnë zemërimin;
- ii. zhvillimin e aftësive të tilla, si zgjidhja e problemeve, ndërgjegjësimi ndaj të dëmtuarit, arsyetimi moral, vetëkontrolli, shmangia e qëndrimeve antisociale dhe ndërveprimi social me qëllim ndryshimin e sjelljes;
- iii. reduktimin ose ndalimin e përdorimit të substancave alkoolike, narkotike apo psikotrope;
- iv. reduktimin e rrezikut të veprave penale që lidhen me gjendjen e dehur; ose
- v. reduktimin e rrezikut të dhunës në familje

e) “Prokurori” ka të njëjtin kuptim me atë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative””.

ë) “Qendra ditore” janë qendrat e rehabilitimit të drejtuar nga OJF-të dhe të frekuentuara nga të dënuarit me qëllim përfshirjen e këtyre të fundit në veprimtari që ndikojnë në sjelljen dhe qëndrimet e tyre, si terapistë që lidhen me artin apo muzikën, diskutimet në grup, aktrimi, letërsia, çdo veprimtari artizanale, apo programet e grupit për trajtimin e sjelljes kriminale.

f) “Shërbimi” është Shërbimi i Provës.

g) “Shërbimi i ndërmjetësimit” është struktura e përbërë nga ndërmjetës që ofron ndërmjetësimin midis të dëmtuarit dhe të dënuarit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9090, datë 26.06.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

gj) “Veprimtari e përkohshme” është çdo veprimtari e realizuar nga OJF-të në territorin e Republikës së Shqipërisë për asistencën, mbështetjen ose rehabilitimin e të dënuarve, për një periudhë nga 30 ditë deri në 6 muaj, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.8788, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”.

h) “VKM-ja 302/2009” është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 302 , datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative””.

KREU II RREGULLAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 3

Rregulla të përgjithshme për bashkëpunimin

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, pasi ka marrë paraprakisht mendimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë, hyn në marrëdhënie bashkëpunimi me OJF-të e regjistruara në regjistrin e hapur sipas pikës “d” të paragrafit 1 të nenit 26 të VKM-së nr. 302/2009, si dhe me Shërbimin e Ndërmjetësimit. Bashkëpunimi bëhet efektiv nën kompetencën territoriale të zyrave vendore të Shërbimit të Provës.

2. Shërbimin i Provës hyn në marrëdhënie bashkëpunimi me OJF-në që:

a) Është ligjërish e regjistruar në Republikën e Shqipërisë;

b) Ka një qëllim dhe një objekt veprimtarie që përputhet me parashikimet e paragrafit 1 të nenit 1 të kësaj rregulloreje;

c) Është e licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit nën kategoritë “Kujdesi shoqëror dhe punësimi”, “Drejtësia dhe ligji” ose “Arsimi”, në përputhje me ligjin nr. 10081, i datës 23.02.2009 “Mbi licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;

ç) Nuk ka shënime për shkelje të detyrimeve të bashkëpunimit në regjistrat e mbajtur nga zyrat vendore të Shërbimit të Provës.

3. Një OJF e huaj, që nuk është e regjistruar dhe nuk ka degë në Republikën e Shqipërisë dhe që është e gatshme të kryejë veprimtari të përkohshme të asistencës, mbështetjes apo rehabilitimit të të dënuarve, mund të hyjë në marrëdhënie bashkëpunimi me zyrën vendore të shërbimit të provës pasi të ketë marrë lejen nga Ministri i Drejtësisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8788, datë 7.05.2001 “Për OJF-të”.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës organizon, të paktën një herë në vit, takime të përbashkëta me përfaqësues nga OJF-të dhe Shërbimi i Ndërmjetësimit për diskutimin e çështjeve thelbësore të bashkëpunimit në fushën e ekzekutimit të dënimeve alternative.

5. Shërbimi i Provës, në përzgjedhjen e OJF-së apo Shërbimit të Ndërmjetësimit me të cilin do të bashkëpunojë në çdo rast konkret, kujdeset për shmangien e konfliktit të interesit të këtyre të fundit me të dënuarin, të dëmtuarin dhe vetëshërbimin.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës monitoron veprimtarinë e OJF-ve dhe Shërbimit të Ndërmjetësimit në lidhje me zbatimin e dënimeve alternative dhe përdorimin e mbështetjes financiare të marrë nga shteti për këtë qëllim.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës përfshin, në regjistrin elektronik të mbajtur sipas paragrafit 3 të nenit 26 të VKM-së nr. 302/2009, të dhëna mbi numrin e memorandumëve të nënshkuara, OJF-të apo Shërbimin e Ndërmjetësimit palë në bashkëpunim, listën e OJF-ve që kanë shkëlur detyrimet sipas paragrafit 3 të nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe mbi programet e njohura si modele të praktikës së mirë të bashkëpunimit.

Neni 4

Parimet e bashkëpunimit

1. Shërbimi i Provës, OJF-të dhe Shërbimi i Ndërmjetësimit në veprimtarinë e tyre udhëhiqen nga parimi i ligjshmërisë.

2. Palët sigurojnë që në veprimtarinë e tyre të mos ketë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, gjinisë, lindjes, gjuhës, kombësisë, etnisë apo origjinës sociale, mendimeve politike apo të tjera, fesë, kushteve fizike apo mendore, statusit ekonomik apo çdo statusi tjetër.

3. Palët gjatë veprimtarisë së tyre respektojnë të drejtat dhe liritë themelore, si dhe dinjitetin e të dënuarit dhe të të dëmtuarit.

4. Palët përpiqen të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe të të dëmtuarit, si dhe të mbështesin e inkurajojnë riintegrimin social të të dënuarit nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe rregullave të ndërveprimit social.

Neni 5

Forma e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi i Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit realizohet nëpërmjet nënshkrimit të memorandumëve të bashkëpunimit, të cilët kanë si objekt një ose më shumë nga veprimtaritë e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 1 të kësaj rregulloreje dhe mund të zhvillohen ndaj një të dënuari apo një grupi të dënuarish.

2. Memorandumet e bashkëpunimit nënshkruhen për një afat të caktuar dhe hyjnë në fuqi me nënshkrimin nga palët. Kur memorandumi nënshkruhet për një afat më të gjatë se një vit, palët sigurojnë një rishikim periodik të përmbajtjes së tij dhe mbajnë takime të paktën një herë në gjashtë muaj me qëllim vlerësimin e veprimtarive të zhvilluara si dhe, kur çmohet e nevojshme, bëjnë propozime për shtesa apo ndryshime në memorandum.

3. Memorandumet mund të ndryshohen dhe/ose shtohen vetëm me miratimin e palëve. Kur shtesat apo ndryshimet prekin thelbin e procedurave të bashkëpunimit, palët përgatisin dhe nënshkruajnë një memorandum të ri.

Neni 6

Përmbajtja e memorandumëve

1. Memorandumet e bashkëpunimit përmbajnë:

- a) Palët nënshkruese;
- b) Zyrën vendore të Shërbimit të Provës që do të ngarkohet me zbatimin e memorandumit;
- c) Llojin e shërbimit që do të ofrohet nga palët;
- ç) Kohëzgjatjen e memorandumit;
- d) Detyrimet e palëve, në veçanti detyrimin në lidhje me raportimin periodik të Shërbimi i Provës dhe të Ministri i Drejtësisë;
- dh) Mënyrën e shkëmbimit të informacioneve konfidenciale;
- e) Mënyrën e dokumentimit të shpenzimeve procedurale;

ë) Formën e monitorimit të zbatimit të memorandumit dhe legjislacionit në fuqi për ekzekutimin e dënimit alternativ dhe masat përkatëse në rast mospërbushjeje të rregullt të tij; si dhe

f) Datën dhe nënshkrimin e palëve.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës miraton modelin e standardizuar të memorandumit të bashkëpunimit.

Neni 7

Përfundimi i memorandumit

1. Memorandumi i bashkëpunimit përfundon në situatat e mëposhtme:

a) Me mbarimin e afatit të bashkëpunimit;

b) Me tërheqjen me shkrim nga çdonjëra prej palëve në rast mospërbushjeje nga pala tjetër të detyrimeve të përcaktuara në memorandum;

c) Kur, si rrjedhojë e mungesës së të dënuarve ose të të dëmtuarve apo mungesës së bashkëpunimit nga ana e tyre në kryerjen e veprimtarive të parashikuara në memorandum, palët bien dakord me shkrim që memorandumit nuk mund të ekzekutohet, duke përcaktuar datën e përfundimit të tij; si dhe

ç) Në rast fillimi të çdo veprimtarie që mund të dëmtojë palën tjetër.

2. Në rastet e parashikuara nga paragrafi “b” dhe “ç” i këtij neni, pala që tërhiqet nga memorandumit njofton me shkrim palën tjetër për përfundimin e memorandumit të bashkëpunimit. Çdo tërheqje e tillë i fillon efektet nga data e marrjes së njoftimit nga pala tjetër.

3. Në rast se OJF-ja apo Shërbimi i Ndërmjetësimit qëllimisht nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në memorandum ose fillon një veprimtari që mund të dëmtojë Shërbimin e Provës, krahas përfundimit të memorandumit:

a) Zyra vendore e Shërbimit të Provës bën shënimin përkatës në regjistrin e OJF-ve të mbajtur prej saj, ku specifikohet shkelja e detyrimeve;

b) Zyra vendore e Shërbimit që ishte palë në memorandum njofton menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës mbi shkeljen e qëllimshme të detyrimeve apo fillimin e veprimtarisë që dëmton shërbimin, me propozimin për ndjekjen e procedurave ligjore për t'i hequr OJF-së përgjithmonë licencën për të ofruar ndonjë nga veprimtaritë e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 1 të kësaj rregulloreje.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës i njofton Ministrit të Drejtësisë përfundimin e memorandumit dhe shkakun e tij.

KREU III

DETYRIMET E PALËVE

Neni 8

Detyrimet e Shërbimit të Provës në raport me OJF-të

1. Kur pas vlerësimit të të dënuarit sipas paragrafit 10 të nenit 24 të VKM-së nr. 302/2009, Shërbimi i Provës identifikon probleme dhe nevoja, për të cilat kërkohet mbështetje nga një OJF, Shërbimi:

a) Harton një letër referencë dhe identifikon OJF-në e përshtatshme dhe të gatshme për ofrimin e veprimtarisë apo shërbimit që nevojitet;

b) I dërgon letër referencën OJF-së jo më vonë se 3 ditë pas datës së vlerësimit;

c) Përfshin në raportin e vlerësimit të përgatitur për prokurorinë apo gjykatën bashkëpunimin me OJF-në dhe rezultatet e tij;

ç) Përfshin në programin individual të trajtimit bashkëpunimin me OJF-në për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, kur është një rast i tillë;

d) I shpjegon të dënuarit qëllimin e bashkëpunimit duke e informuar rreth llojit të veprimtarisë që do të kryhet nga OJF-ja;

dh) Komunikon me personin përgjegjës për rastin të caktuar nga OJF-ja për të rënë dakord mbi datën dhe orën, në të cilën i dënuari i shoqëruar nga punonjësi i shërbimit do të paraqiten pranë OJF-së;

e) Vë në dijeni të dënuarin për rregullat që duhen respektuar në marrëdhëniet me OJF-në dhe detyrimet e tij për të marrë pjesë në veprimtaritë e programuara nga OJF-ja duke i shpjeguar pasojat e mosrespektimit të këtyre rregullave dhe mospërbushjes së këtyre detyrimeve;

ë) Përcakton në bashkëpunim më mbikëqyrësin, mënyra konkrete të monitorimit të ekzekutimit të dënimit dhe detyrimeve nga i dënuari;

f) Siguron që llojet e veprimtarive që do të kryhen nga i dënuari, të përcaktuara fillimisht, nuk do të ndryshojnë në një masë të tillë sa të mos përputhen me nevojat dhe aftësitë e personit;

g) Kryen vizita të rregullta në përputhje me kohën e përcaktuar në letër referencë, si dhe vizita të palajmëruara për të verifikuar nëse i dënuari po i përmbush si duhet detyrimet e tij pranë OJF-së;

gj) Kontrollon dosjen e mbajtur nga OJF-ja për të dënuarin për të verifikuar nëse informacioni i përfshirë në të është objektiv dhe lidhet vetëm me çështjet dhe veprimtaritë që janë objekt i bashkëpunimit;

h) Njofton prokurorin, në rast mospërbushjeje të detyrimeve nga i dënuari, pasi të ketë marrë një njoftim të motivuar nga OJF-ja dhe pasi të ketë verifikuar informacionin;

i) Njofton prokurorin kur çmohet se për arsye objektive i dënuari nuk mund të përmbushë detyrimin dhe dënimi i vendosur nuk mund të ekzekutohet;

j) Përfshihet aktivisht në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarive të OJF-së me qëllim sigurimin që OJF-ja i përmbush detyrimet e saj dhe shërbimi që i ofrohet të dënuarit është cilësor dhe eficient.

2. Kur Shërbimi i Provës e vlerëson një program të sjelljes kriminale të hartuar dhe realizuar nga një OJF si të suksesshëm dhe të dobishëm, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës njohjen e këtij programi me qëllim që të përdoret si shembull i praktikës së mirë nga zyra të tjera vendore të shërbimit dhe nga OJF-të.

Neni 9

Detyrimet e Shërbimit të Provës në raport me Shërbimin e Ndërmjetësimit

1. Kur Shërbimi i Provës nga vlerësimi i të pandehurit çmon se rasti është i përshtatshëm për ndërmjetësim midis të dëmtuarit dhe të dënuarit, ai:

a) Harton një letër referencë për të dënuarin dhe komunikon me Shërbimin e Ndërmjetësimit për të siguruar një ndërmjetës të pavarur dhe të paanshëm për zhvillimin e procedurës së ndërmjetësimit;

b) I dërgon Shërbimit të Ndërmjetësimit letër referencën jo më vonë se 3 ditë pas vlerësimit të nevojës për ndërmjetësim;

c) Informon të dënuarin mbi mundësinë që ka për t'i ofruar këshillim dhe mbështetje për të ndërmjetësuar me të dëmtuarin;

ç) Komunikon me personin përgjegjës të caktuar nga Shërbimi i Ndërmjetësimit për të rënë dakord mbi datën dhe orën, në të cilën i dënuari i shoqëruar nga punonjësi i shërbimit do të paraqiten pranë institucionit;

d) Përfshin në raportin e vlerësimit të përgatitur për prokurorinë apo gjykatën bashkëpunimin me Shërbimin e Ndërmjetësimit dhe rezultatet e tij;

dh) Informon gjykatën kur çmohet se për arsye objektive ose subjektive ndërmjetësimi është i pamundur të realizohet;

e) Përfshihet aktivisht në zbatimin dhe monitorimin e veprimtarive të Shërbimit të Ndërmjetësimit që realizohen në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit me qëllim sigurimin që Shërbimi i Ndërmjetësimit i përmbush detyrimet e saj dhe shërbimi që i ofrohet të dënuarit është cilësor dhe eficient.

2. Kur si rrjedhojë e ndërmjetësimit, midis të dënuarit dhe të dëmtuarit është arritur një marrëveshje për zgjidhjen me pajtim të çështjes penale dhe kur kjo nuk bie në kundërshtim me ligjin, Shërbimi i Provës njofton me shkrim prokurorin rreth kësaj marrëveshjeje.

3. Kur si rrjedhojë e ndërmjetësimit, verifikohen rrethanat e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar nga vepra penale ose të ndihmës aktive për zhdukjen ose pakësimin e pasojave të saj dhe të normalizimit të marrëdhënieve, por ligji nuk lejon zgjidhjen e çështjes penale me pajtim, Shërbimi i Provës i përshkruan këto rrethana në raportin e vlerësimit.

4. Në rastin e të dënuarve, veçanërisht të atyre që kërkojnë lirim me kusht, shërbimi, identifikon të dëmtuarin dhe shqetësimet e tij të mundshme që lidhen me kthimin e të dënuarit në komunitet dhe parashikon në raportin e vlerësimit dhe në planin individual të trajtimit bashkëpunimin me Shërbimin e Ndërmjetësimit me qëllim normalizimin e marrëdhënieve midis të dënuarit dhe të dëmtuarit.

Neni 10

Detyrimet e OJF-së

1. Në marrëdhënien e bashkëpunimit me Shërbimin e Provës, OJF-ja:

a) Cakton një ose më shumë persona përgjegjës për zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit dhe i komunikon shërbimit të dhënat e kontaktit të tyre;

b) Takohet me përfaqësuesin e shërbimit dhe të dënuarin për të diskutuar rreth veprimtarive apo ndërhyrjeve të propozuara për t'u kryer nga OJF-ja;

c) Përgatit, bazuar në letër referencën dhe në takimin me të dënuarin, një plan me shkrim të veprimtarive që do të kryhen, duke përmendur llojin, vendin, kohën e tyre dhe, kur është e nevojshme, specifikon nëse personi do të përfshihet në një program rehabilitimi individual, grupi apo familjar;

ç) I dërgon kopje të planit të veprimtarive të dënuarit dhe shërbimit;

d) Siguron vlerësimin e specializuar, kur për hartimin e raportit të vlerësimit nevojitet një analizë e specializuar të dënuarit dhe ia dërgon përfundimet me shkrim shërbimit brenda afatit për të cilin palët kanë rënë dakord;

dh) Realizon në praktikë llojet e veprimtarive, për të cilat palët kanë rënë dakord në kuadër të planit të veprimtarive;

e) Harton, realizon, rishikon dhe vlerëson programin në përputhje me planin e veprimtarive në rastin kur i dënuari është përfshirë në një program të sjelljes kriminale;

ë) Monitoron në mënyrë të vazhdueshme efektivitetin e zhvillimit të veprimtarive, si dhe performancën e të dënuarit duke informuar me shkrim shërbimin rreth rezultateve të monitorimit dhe, kur e çmon të nevojshme, propozon ndryshimin e planit fillestar të veprimtarive;

f) Informon shërbimin mbi çdo mungesë të të dënuarit apo sjellje të tij që do të rrezikonte vazhdimin e veprimtarive dhe ekzekutimin e vendimit gjyqësor;

g) I përgjigjet me shkrim çdo kërkesë të shërbimit për informacion mbi një rast të caktuar bashkëpunimi;

gj) I dërgon shërbimit një raport përfundimtar për çdo të dënuar duke përshkruar performancën e të dënuarit, progresin e tij, arritjen ose jo të qëllimit të veprimtarisë dhe çdo koment tjetër që mund të çmohet i nevojshëm.

2. Për çdo të dënuar, OJF-ja hap një dosje të veçantë, e cila përfshin:

a) Memorandumin e bashkëpunimit të nënshkruar me Shërbimin e Provës në lidhje me rastin konkret;

b) Një fotokopje të dokumentit të identifikimit të të dënuarit;

c) Letër referencën e paraqitur nga Shërbimi i Provës sipas parashikimeve të pikës “b” të paragrafit 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje;

ç) Raport mjekësor për vlerësimin e kushteve shëndetësore të të dënuarit, kur është e nevojshme;

- d) Planin e veprimtarive të hartuar në përputhje me pikën “c” të paragrafit 1 të këtij neni;
 - dh) Përfundimet e vlerësimit të specializuar të realizuar sipas pikës “d” të paragrafit 1 të këtij neni;
 - e) Programin e sjelljes kriminale të hartuar në përputhje me pikën “e” të paragrafit 1 të këtij neni;
 - ë) Aktet informuese drejtuar Shërbimit të Provës në lidhje me rezultatet e monitorimit të realizimit të veprimtarisë së të dënuarit sipas pikës “ë” të paragrafit 1 të këtij neni; si dhe
 - f) Raportin përfundimtar të hartuar mbi të dënuarin në përputhje me pikën “g” të paragrafit 1 të këtij neni.
3. Dosja e mbajtur sipas paragrafit 2 të këtij neni i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës brenda 10 ditëve nga përfundimi i memorandumit, ku dhe arkivohet. OJF-ja mban kopje të dosjes.
4. OJF-ja në veprimtarinë e saj respekton kërkesat e ligjit nr. 9877, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 11

Detyrimet e Shërbimit të Ndërmjetësimit

1. Në marrëdhënien e bashkëpunimit me Shërbimin e Provës, Shërbimi i Ndërmjetësimit:
 - a) Depoziton pranë shërbimit listën e ndërmjetësve me gjeneralitetet dhe kontaktet e tyre dhe i rekomandon shërbimit ndërmjetësit e përshtatshëm për rastet konkrete;
 - b) Siguron që të gjithë ndërmjetësit që ofrojnë shërbimin e tyre në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit janë të trajnuar në çështje të ndërmjetësimit midis të dëmtuarit dhe të dënuarit dhe të drejtësisë restauruese;
 - c) Kryen veprimet e nevojshme për të kontaktuar dhe, kur është e nevojshme, për të takuar, veçmas të dëmtuarin dhe të dënuarin me qëllim përgatitjen e tyre paraprake për seancat e ndërmjetësimit;
 - ç) Informon zyrën vendore të shërbimit mbi përputhshmërinë e çdo rasti me programet e ndërmjetësimit;
 - d) Siguron që çdo program ndërmjetësimi të zhvillohet në mënyrë të përshtatshme dhe të ndiqet nga ndërmjetës të aftë për të përgatitur dhe siguruar një takim të qetë dhe të sigurt të të dëmtuarit me të dënuarin;
 - dh) Përfshin në programet e ndërmjetësimit edhe prindërit e të dënuarit, kur ky i fundit është i mitur;
 - e) Kur është e përshtatshme, përfshin në programet e ndërmjetësimit, anëtarë të komunitetit, familjarë, juristë apo dhe punonjës të shërbimit të provës, me qëllim arritjen e rezultateve në përmirësimin e marrëdhënies midis të dëmtuarit dhe të dënuarit, riparimin e dëmit të shkaktuar dhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale;
 - ë) Informon shërbimin mbi ecurinë e procesit të ndërmjetësimit në mënyrë periodike;
 - f) Zhvillon ndërmjetësimin në mënyrën më të përshtatshme për të dëmtuarin dhe të pandehurin mbështetur në rrethanat e kryerjes së veprës penale, pasojat e saj dhe sjelljen ndërmjet tyre;
 - g) Informon shërbimin kur çmon se për arsye objektive apo subjektive procesi i ndërmjetësimit nuk mund të kryhet, duke përshkruar dhe shkaku;
 - gj) I përgjigjet me shkrim çdo kërkesë të shërbimit për informacion mbi një rast të caktuar bashkëpunimi;
 - h) Siguron që programet e ndërmjetësimit i përshtaten dhe mbajnë parasysh nevojat dhe shqetësimet e të dëmtuarit.
2. Në përfundim të programit të ndërmjetësimit, Shërbimi i Ndërmjetësimit:
 - a) I paraqet Shërbimit të Provës një raport rreth zhvillimeve të programit dhe rezultateve të arritura. Në raport përfshihet informacion mbi arritjen ose jo të një marrëveshjeje dhe mbi mundësinë e kërkesës së përfundimit të procedimit penal sipas ligjit;

b) I paraqet kopje të raportit të ndërmjetësimit të dëmtuarit, të dënuarit dhe çdo personi që ka marrë pjesë në programin e ndërmjetësimit;

c) Kur është arritur një marrëveshje midis të dënuarit dhe të dëmtuarit, ndjek në vijimësi përmbushjen e marrëveshjes nga ana e të dënuarit dhe i raporton shërbimit mbi përmbushjen ose jo të detyrimeve të marra përsipër nga i dënuari;

3. Shërbimi i Ndërmjetësimit, në veprimtarinë e tij, respekton kërkesat e ligjit nr.9877, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë

Hyri në shtyp më 3.9.2009
 Doli nga shtypi më 5.9.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë